




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/85  
Datë: 22.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministrie e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*  
*Ministravo Kulturne, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport*

---

KONCEPT – DOKUMENTI PËR FUQIZIMIN DHE PJESËMARRJEN E RINISË

## **KONCEPT - DOKUMENTI**

**Kapitulli 1: Hyrje**

**Kapitulli 2: Përshtrimi dhe definimi i çështjes/problemët kryesor**

**Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat**

**Kapitulli 4: Opcionet**

**Kapitulli 5: Përbledhje e opioneve**

**Kapitulli 6: Analiza e opioneve**

**Kapitulli 7: Konsultimi**

**Kapitulli 8: Krahasimi i opioneve (vlerëso pasojat e secilit opzion)**

**Kapitulli 9: Rekomandimi**

**Kapitulli 10: Komunikimi**

## **Kapitulli 1. Hvre**

Krijimi dhe zhvillimi i politikave dhe mekanizmave të përshtatshëm për fuqizimin dhe pjesëmarjen e rinisë sikurse dhe avancimi i infrastrukturës ligjore me qëllim të krijimit të kushteve adekuate teknike dle profesionale, janë objektiva institucionale dhe njëherazi prioritetet aflatimesme të parapara dhe në politikat si dhe dokumentet relavant strategjike. Në këtë kuadër, sektori i rinisë dhe mbështetjes institucionale të saj, paraqitet edhe në kuadër të Vizionit Programor 2017-2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht si një ndër katër shtyllat strategjike të këtij vizioni, që kësosoj dëshmon për rëndësinë dhe njëherazi përkushtimin institucional për mbështetjen dhe avancimin e sektorit respektiv. Lidhur me këtë, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, në funksion të përkrahjes dhe avancimit te sektorit të rinisë, ka paraparë një mori masash e objektivash sikurse Pjesëmarja e të rinjve, Edukimi Jo Formal, Promovimi shëndëfesor i të rinjve, siguria e të rinjve, integrimi shoqëror, Vullnetarizmi, Sporti, Kultura dhe Rekreacioni. Në këtë kuadër politikat rinore kanë rëndësi të madhe për të gjithë të rinjtë të cilat ofrojnë mundësi dhe zgjidhje për nevojat dhe kërkosat e të rinjve pa dallim etnikë apo gjinore, si dhe ofrojnë mundësi të barbaret të zhvillimit të të gjithë të rinjve si dhe ofrojnë perspektiven adekuate të barabartë në arrijken e mirëqenies së tyre. Në suaza të ndërtimit të politikave rinore rëndësi të veçantë ka infrastruktura ligjore. Pa avancim të bazës ligjore konform praktikave vendore dhe atyre rajonale dhe standardeve evropiane e ndërkombëtare, nuk mund të ndiqen zhvillime të shumta dinamike të shtetit dhe shoqërisë. Lidhur me këtë, rishikimi dhe plotësimi i kornizës aktuale ligjore mbetet kërkosë e kohës dhe në pajueshmëri me Programin e Qeverisë 2017-2021<sup>1</sup>, dhe përputhshmëri dle me listën e koncept dokumenteve te Qeverisë për vitin 2018<sup>2</sup>. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Planit Vjetor të Punës se Qeverisë tek objektivi Promovimi dhe mbështetja e pjesëmarjes se te rinjve dhe tek lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2018 ka parapare hartimin e koncept dokumentin për Fuqizimin dhe Pjesëmarjen e Rinisë. Me rastin e hartimit te këtij dokumenti janë konsultura Strategjia dhe Plani i Veprimit për Rini, instrumentet ndërkombëtare dhe përputhshmëria me angazhimet e Kosovës në procesin e integrimit evropian sikurse Strategjia e të Rinjve e Bashkimit Evropian 2010-2018, si dhe dokumentet tjera si në vijim: The Interim Evaluation of the EU Youth Strategy and the Council Recommendation on the Mobility of Young Volunteers, Joint Report of the Council and the Commission on the implementation of the renewed framework for European cooperation in the youth field (EU Youth Strategy 2010-2018)<sup>3</sup>, Konkluzionet nga Forumi i Triestës si dhe obligimet ligjore në kuadër të Zyres Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)<sup>4</sup>.

Koncept dokumenti për Fuqizim dhe Pjesëmarje të Rinisë adreson politikat rinore në nivel shtetëror, e që ndërlidhen me trajimin e çështjeve të rëndësishme rinore. Në këtë dokument janë përfshirë sfidat të cilat e kanë përcjellë zbatimin e ligjtit në fuqi (Ligjt Nr.

---

<sup>1</sup> Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021

<sup>2</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Koncept Dokumentet, [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/194-Lista\\_e\\_Koncept\\_Dokumenteve\\_per\\_vitin\\_2018\\_alb\\_srb\\_ang.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/194-Lista_e_Koncept_Dokumenteve_per_vitin_2018_alb_srb_ang.pdf), 02.02.2018

<sup>3</sup> European Commission, [http://ec.europa.eu/assets/eac/youth/policy/documents/eu\\_youth\\_report\\_2012\\_communication\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/assets/eac/youth/policy/documents/eu_youth_report_2012_communication_en.pdf), 12.02.2018

<sup>4</sup> Konkluzionet nga Forumi i Triestës si dhe obligimet ligjore në kuadër të Zyres Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)

03/L-145 për Fudqizim dhe Pjesëmarje të Rinisë) si dhe specifikat dhe ngjarjet e zhvillimeve tjera të deritashme në Kosovë dhe në politikat rinore të Bashkimin Evropian, bazuar në kornizën strategjike të BE 2010-2018<sup>5</sup>. Ky koncept është rezultat i kërkesave dhe nevojave të reja të parashtruara nga të rinxjtë dhe organizatat rinore nga niveli lokal rinor e deri të niveli shtetëror si dhe në funksion të zbatimit të Strategjisë së të Rinjve të BE në trajimin e çështjeve rinore dhe dokumenteve relevante strategjike.

## **Kapitulli 2. Përshtkimi dhe definimi i çështies/problemmit kryesor**

Koncept dokumenti paraqet një bazë të qëndrueshme për të vazhduar përkrahjen e të rinxjve në fushat e politikave sektoriale si dhe duke i'u përshtatur nevojave dhe kërkesave të rinxjve në të dy nivelet e pushteve në atë lokal dhe atë qendror. Nevoja e rishikimit të kornizës ligjore në fuqi bazohet në sfidat e identifikuara gjate zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar si dhe rrithanave të reja të krijuara për gjatë kësaj periudhe kohore siç janë: mosha, edukimi, punësimi tek të rinxjtë kosovarë, zhvillimi i njojurive rrëth inovacioneve të prezantuara si nevojë e kohës së sotme, njohja e punës vullhetare, çështja e stimulimit më të madh të të rinxjve në krijimin dhe zbatimin e politikave në vendimarrje, pjesëmarrien aktive të rinxjve në punën vullhetare, shkëmbimi i përvojave në punë të punëtorëve të rinxjve si dhe angazhimin e të rinxjve ne projektet rinore rajonale dhe ndërkombëtare.

Koncept dokumenti synon të adresoj si në vijim çështjet: Edukim dhe edukimi jo -formal, punësimi, ndërmarrësia rinore në fushë e riniçë etj. **Koncepti Dokumenti ka synim të eliminojë disa mangesi nga ligji aktual të identifikuara për gjatë periudhës implemetues:** si mos trajtimin me ligji të personave mbi moshën 24 vjeç, mos adresimin e politikave rinore në ndërmarrësi, mos qartësimi i veprimit të shumë mekanizmave rimore, ndryshimet e shpeshta të kodeve buxhetore në nivel qendror dhe lokal përmes politikave shpenzuese të brendshme të organizatave buxhetore, mos trajtimi i barabartë i OJQ rinore, ndarja e tyre si lokale dhe qendrore nga komunitat, mos dhënia mundësi që edhe komunitat të kenë strategjji lokale për të rinxj , që do të duhej të ishin në përgjithësi në pajtim edhe me strategjinë nationale rimore, lehtësimi funksional i OJQ rimore. Ligji ne fuqi nuk ofron zhvillimin e qëndrueshëm të mekanizmave joçeveritar e as të Qendrave Rimore, ligji në fuqi nuk institucionalizon qendrat rimore në kuqtimin e qëndrueshëm financiar. Ligji aktual në fuqi nuk rregullon formalisht bashkëpunimin ndërkombëtar rajonal dhe ndërkombëtar dhe nuk ofron lehtësim funksionale të bashkëpunimit rimore ndërkombëtar përdherisa zhvillimet rajonale kanë ndryshuar. Ligji aktual nuk përbën zhvillimet tjera në fushën e njohjes së punës praktike dhe njohjes së platformës së vullnetarëve.

### **2.1. Politikat aktuale si në vijim:**

---

<sup>5</sup> EU Youth Strategy [https://ec.europa.eu/youth/policy/youth-strategy\\_en](https://ec.europa.eu/youth/policy/youth-strategy_en), 12.01.2018

## Ligjet dhe Aktet Nënligjore:

### 2.1.1. Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë

Dispozitat e këtij ligji kanë për qëllim avancimin dhe riafirmimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarries, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi, në zhvillimin e një shoqërie demokratike, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror. Ligji aktual në fuqi nuk rregullon çështjet e ndryshimeve të rrëthanave të vazhdueshme dhe evoluimit të politikave rinore me standardet evropiane dhe situatave tjera zhvillimore si çështjet e identifikuar në kapitullin dy të konceptit, po ashtu as aktet nënligjore te MKRS/DIR nuk rregullojnë këto çështje të identifikuar. Mungesa e trajimit edhe me akte dytësore dhe mbi të gjitha mos dhënia e bazës ligjore adekuat. Ligji aktual dhe aktet e deritashme ne fuqi, nuk janë kane efikase në trajimin e çështjeve të politikave rinore.

### 2.1.2. Strategjia për Rini

### 2.1.3. Plani për Veprim Rinor

## 3. Aktet nënligjore

Aktet normative që kanë për qëllim të rregullojnë këto çështje janë:

### 1. Udhëzim Administrativ Nr. 01/2016 për Punën Vulnetare të të Rinjve.

2. Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2015 për Edukimin Joformal të të Rinjve që ka për qëllim të riafirmojë pjesëmarrjen dhe fuqizimin e të rinjve në politikat sektoriale përmes ofrimit të edukimit joformal për të rinjtë.

3. Udhëzimin Administrativ Nr. 11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore që ka për qëllim licencimin e qendrave rinore nëpër Komuna.

4. Udhëzimin Administrativ Nr. 9/2010 për Përgjegjësit dhe Procedurat e Themelimit dhe Funksionalizimit të Këshillit të Veprimit Rinorë, që ka për qëllim të përcaktojë përgjegjësit, procedurat për themelimi, funksionimin dhe formën e regjistrimit të këshillit të veprimit rinor në Kosovë.

## **5. Përvojat në shtetet tjera:**

Bazuar në zhvillimet e politikave rimore Kosova udhëheq politika rimore ne përpunë me standarde tħalli Ballkanin Perëndimor si dhe bazuar në kuadër të zhvillimeve shtetërore rajonale tē cilat kanë objektiva tē bazuara në dokumente evropiane<sup>6</sup>.

Bazuar në përvojat e shteteve te rajonit dhe BE, mosha rimore sipas ligjeve pér tē rinet ( Mali i Zi moshën rimore e ka përcaktuar prej: 15 deri 30 vjeç, Maqedonia: 15 deri 24 vjeç me tendençë tē ndryshimit deri 30 vjeç, Shqipëria: prej 15 deri 29 vjeç, Kroacia: prej 15 deri 29 vjeç. Bazuar në tē dhënat e EUROSTAT mosha është e percaktuar prej 15 deri 29 vjeç<sup>7</sup>.

Kosova mbetet e përkushtuar që tē ndjek politikat dhe përvojat rimore evropiane si per nga mosha, zhvillimi i politikave rimore përmes strategjive , planeve te veprimit riner, programeve dhe stimulimeve tē aktiviteteve rimore përmes punës vullnetare , shkëmbimeve programore edukative.

## **Kapitulli 3. Synimet dhe objektivat**

**Synimi: Fuqizimi dhe pjesëmarrja e rinise ne proceset politikberëse, vendimmarrëse dhe nxitjes se qytetarisë aktive tek te rinjet.**

**Objektivat:**

1. Rritja e grup-moshës si një nevoje e theksuar pér përmirësimin e situatës dhe krijimin e mundësive me te mëdha pér përfshirje me te gjere ne aktivitetet rimore.
2. Rritja e mundësive te përkrahjes se programeve qe rrisin punësimin e te rinjve.
3. Vullnetarizmi ne funksion te përmirësimit te kulturës qytetare pér përfshirje dhe nxite te aktiviteteve vullnetare.

---

<sup>6</sup> The Connecting Youth – Moving Forward EU-Western Balkans Youth Forum took place on 11-12 July 2017 in Trieste in the margins of the Western Balkans Summit

<sup>7</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Being\\_young\\_in\\_Europe\\_today\\_-\\_demographic\\_trends](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Being_young_in_Europe_today_-_demographic_trends)

#### **4. Zhvillimi i avancuar i politikave rimore si rezultat i evoluimit te rrethanave ekzistuese.**

Bazuar në këto objektiva bënë përpjekje që të përmirësoj zbatimin dhe efikasitetin e veprimit të politikave programore në drejtim të nxitjes se pjesëmarrjes më massive dhe më përfaqësuese të të rinjve, më pro aktive në vendimmarje përmes krijimit të një bazë ligjore të zbutueshme dhe zhvillimore nga pushteti qendror dhe pushteti lokal, përmes përfshirjes së organizatore rimore në vendimmarje duke marr obligime të drejtëpërdrejta ne pjesën e zbatimit të politikave programore. Politikkëbëra dhe vendimmarja do të ndryshojë në favor të avancimit të të drejtave të rinjve ne konsultim për ndërtimin e strategjive dhe programeve ne nivelin qendror dhe në nivelin lokal, duke marr pjesë aktive në hartimin e politikave dhe bëjen e një kodit të veçantë për subvencione për të rinjtë. Nxitja e programeve trajnuese për të rinjtë në sferën e përgatitjeve për tregun e punës përmes stimulimeve ligjore janë bazë e qëndrueshme për një rini të përgatitur dhe të shkaktë për punësim.

#### **Kapitulli 4: Opcionet**

##### **Opcioni i 1. Status quo (asnje ndryshim)**

Opcionet: Gjendja e tanishme status quo

Opcionet:

1. Nëse vazhdohet me politikat e njëjta të përcaktuara te deritashme do të mbeten pa u trajtuar një varg çështjesh qe me kalimin e kohës kanë evoluar dhe kanë mbet jashtë trajtimit adekuat ligjor dhe jashtë përputhjes me zhvillimet e reja ne politikat sektoriale vendore dhe në raport me BE.

2. Nëse vazhdohet me komizën aktuale ligjore do të mbeten pa u trajtuar çështjet në mënyrë me adekuatë dhe me specifikë.

3. Aktualisht korniza ligjore nuk plotëson kërkesat dhe nevojat rimore në kontekste të fuqizimit dhe pjesëmarrjes së rinisë.

##### **Opcioni 2. Ndryshimi i politikës ekzistuese**

1. Politikat dhe angazhimet aktuale mund të ndryshohen vetëm me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinjeve me qellim të rregullimit të fushave përkatëse krahas praktikave më të mira rajonale dhe në përputhje me politikat e BE.

2. Projektligji për plotësim dhe ndryshim e ligjt për Fuqizim dhe Pjesëmarje të Rinisë Nr. 03/L-145.

3. Pas plotësim-ndryshimit te ligjt parashihen politikat vtdijisuese lidhur me zbatimin e ligjt si dhe do të organizohen fushata për promovimin e aktiviteteve qe lidhen për zbatimin e ligjt.

**Përkufizim:** MKRS është kompetente dhe e obliguar të vaproj në pajtim me rrëhanat dhe zhvillimet dhe është përgjegjëse për zbatimin e politikave adekuate për fushat rimore dhe në pajtueshmëri me politikat rimore të BE. Zbatimi i ligjt dhe mbikëqyrja e zbatimit është përgjegjësi e MKRS-së.

### Opsiuni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

1. Nëse nuk dyshohet/plotësohet Ligji për Pjesëmarje dhe Fuqizim të Rinisë nuk mund të implementohen politikat e reja me ligjin aktual në fuqi. Ndryshimi dhe plotësimi i ligjt është e vetmja alternativ për të adoptuar ligjin në pajtim me rrëhanat e reja të politikave qeveritare qe obligimet ndaj proceseve integruar të BE, ligji aktual i cili vlerësohet se nuk përban norma juridike nuk mund të plotësohet përmes nxjerjes se udhëzimeve administrative.
2. Për mospërbushje të obligimeve për shkak te vakumit të bazës ligjore përgjegjës do të ishte MKRS dhe Qeveria andaj është e domosdoshme të bëhen plotësimet dhe ndryshimet adekuatë.
3. Nxjerrja e akteve tjera nënligjore nuk mund të zëvendësojnë në asnjë mënyrë plotësimet dhe ndryshimet e ligjt. As edhe ndonjë program plotësues dhe as strategjia e re apo plani i veprimit nuk mund të aprovojnë implementimin e politikave te reja te parapara nga rekomandimet e dala nga Institucionet qendrore e as institucioneve lokale , OJQ dhe obligimet qe rrijedhin nga BE.

## **Kapitulli 5. Përbledhje e opsiioneve**

Përbledhje e Opzioniave			
Karakteristikat kryesore e opsiioneve	Opsioni 1	Opsioni 2	
Ruajtja e status quo së politikat ekzistuese.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Pjesëmarrije dhe deri ne moshën 29 vjeç te rinjë, duke iu bere te mundur trajnimin dhe edukimin ndërmarrësi që do të lehtësoj punësimin e të rinjve. Do të mundësoj funksionimin e OJQ rimore në mënyrë të barabartë pa diskriminim e qe deri me tash komunat i kanë ndarë në OJQ lokale gjë qe bie ndesh me Ligjin e funksionimit te OJQ-i, Ministria, komunat do te kenë kodë te veçantë buxhetor rimore, hartimi i strategjive lokale rimore do të ndihmojë nivelin lokal të kujdeset për politikat rimore. Lehtësimimi i OJQ rimore për të marr pjesë në programet rimore. Do te rregulloje punën vullnetare të rinjve dhe do të njehë stazhin punues. Me ndryshimet e reja Qendrat Rimore do të fitojnë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Pjesëmarrije dhe deri ne moshën 29 vjeç te rinjë, duke iu bere te mundur trajnimin dhe edukimin ndërmarrësi që do të lehtësoj punësimin e të rinjve. Do të mundësoj funksionimin e OJQ rimore në mënyrë të barabartë pa diskriminim e qe deri me tash komunat i kanë ndarë në OJQ lokale gjë qe bie ndesh me Ligjin e funksionimit te OJQ-i, Ministria, komunat do te kenë kodë te veçantë buxhetor rimore, hartimi i strategjive lokale rimore do të ndihmojë nivelin lokal të kujdeset për politikat rimore. Lehtësimimi i OJQ rimore për të marr pjesë në programet rimore. Do te rregulloje punën vullnetare të rinjve dhe do të njehë stazhin punues. Me ndryshimet e reja Qendrat Rimore do të fitojnë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Politikat ekzistuese sektoriale nuk mund te përbushen pa aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimit te ligjit. Mos ndryshimi dhe plotësimi i ligjit ne fuqi do te ketë për passojë juridike mos plotësim dhe mos efikasitet të trajtimit te paraqiste dështim ndaj obligimeve ligjore dhe kushtetuese.</li> </ul>

			qëndrueshmëri funksionale përmes përkrahjes stimulative dhe rolet tjera që do të marrin këto qendra si ai edukues. Bashkëpunimi ndërkombetar do të avancoj dhe do të stimulojë ligji sidomos OJQ e të rinjve të bashkëpunojnë me programe të avancuara.
- Përbushja e këtyre obligimeve do të ndihmojë në plotësimin e domosdoshëm të nevojave dhe kërkeseve e dala te deritashme nga të rinjtë.	Të rinjtë e Republikës së Kosovës	Të rinjtë e Republikës së Kosovës	Të rinjtë e Republikës së Kosovës
Segmenti I popullsisë/sektori/raioni i shënjestrua	Karakteristika e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Administrimi dhe zbatimi i politikave rinore ose shërbimit	- Ministria e Kulturës, Rinës dhe Sportit	- Ministria e Kulturës, Rinës dhe Sportit	- Ministria e Kulturës, Rinës dhe Sportit
Ligji dhë aktet tjera nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e kornizës ekzistuese si dhe zbatimi adekuat i politikave rinore	Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të aktet nënligjore	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë
Kostoja e zbatimit	Pa ndikime shtesë buxhetore	Pa ndikime shtesë buxhetore	Pa ndikime shtesë buxhetore
Konsultimi publik dhe hyrja ne fuqi e ligjit me ndryshime dhe përmirësime	Fushata vetedijesuese	Fushata vetedijesuese	Fushata vetedijesuese

Kapitulli 6. Analiza e opsiioneve

Përfitimet:

1. Opsioni i 1 (parë), (status quo): Sipas opsimonit 1 përfitime do të jenë vetën ato që deri me tani ishin, duke mos u shtuar obligime te reja, pra vetën ato ekzistuese dhe te deritanishme , përkatësisht ato që kanë buruar nga zbatimi i kornizës aktuale ligjore dhe akteve nënligjore

2. Opsiioni i 2 (dytë): Përmes këtij opzioni, përkatesisht plotësim/ndryshimit të Projektligjtit për Pjesëmarje dhe Fuqizim të Rinisë do të arrihet të krijohen politika të reja rimore.

3. Opsiioni i 3 (tretë): Nëse ligji nuk ndryshohet vazhdohet me zbatimi e politikës ekzistuese me pasoja të mos përbushjes se obligimeve në rrëhana plotësisht të reja të krijuara për gjatë kësaj periudhe kohore duke pas parasysh mangësitë në trajimin e çështjeve qe derivojn nga situatat e caktuara dhe zhvillimet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

#### **Pasoja negative dhe pozitive:**

1. Opsiioni i 1 (parë) - Ndikimet negative do të evidentohen dhe do të përsfaqen kryesisht stagnimet në qasje ndaj zhvillimeve aktuala, pasoja dhe mangësi.
2. Opsiioni i 2 (dytë). - Nuk ka pasoja negative nëse vendoset sipas këtij opzioni. Do të krijohet një ambient pozitiv në trajtim adekuat i çështjeve rimore dhe do të ketë angazhimë bazuar në rrëhanat dhe kërkesat si dhe nevojat e të rinjve në Republikën e Kosovës.
3. Opsiioni i 3 (tretë). - Vlen i njëjtë përshtkim i pasojave negative si në opzionin e parë.

#### **Efekti shpërndarës:**

1. Hartimi i Projektligjit për Plotësim/Ndryshimin e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë sjellë përfitime adekuate në përputhje me interesat e te rinjve.
2. Përfitimet dhe pasoja negative të elaboruara, lidhur me të gjitha opzionet e shtjelluara apo të konsideruara si pjesë hulumtuese më rendësi, nuk janë të lindhura me rajone apo pjesë të caktuar të Republikës së Kosovës, por ato kanë efekt të përgjithshëm në tërë territorin e shtetit.
3. Ndikimet e opioneve të konsideruara apo shtjelluara janë të njëjtë për të gjithë qytetaret pa dallim etnik dhe veprojnë njëjtë në të dy gjinjtë, pra nuk ka efekte dalluese në baza gjinore e tjera.
4. Kosto:

4.1. Vlerësimi i ndikimit financier nuk parashihet kosto shtesë në zbatim të liggjit me plotësimë dhe ndryshime.

4.2. Vlerësimi tabelar I buxhetit të Departamentit të Rinisë

Departamenti i Rinisë						
Buxheti	Viti	Shuma	Viti	Shuma	Viti	Shuma
Pagat dhe mëditjet	2018	146,102.29	2019	156,480.00	2020	156,844.54
Subvencione	2018	1,400,000.00	2019	1,750,000.00	2020	1,750,000.00
Mallra dhe shërbime	2018	6,300.00	2019	6,300.00	2020	6,300.00
Komunali	2018	/	2019	/	2020	/
Investime kapitale	2018	1,150,000.00	2019	600,000.00	2020	600,000.00
<b>Buxheti total</b>	<b>2018</b>	<b>2,702,402.29</b>	<b>2019</b>	<b>2,512,780.00</b>	<b>2020</b>	<b>2,517,344.54</b>

5. Për zbatimin e ligjit do të jenë institucionet e njëjtë të evidentuara në pikën 3 të opzionit 2.

**Kapitulli 7. Konsultimi**

Me rastin e hartimit të këtij projektligji janë konsultuar institucione relevante si, Ministria e Arsimit, Drejtorit Komunale për Kulturë Rini dhe Sport, Këshilli Qendror i Veprimit Rinore dhe Këshillat e Veprimeve Rinore Lokale , Kuvendi i te Rinjve të Kosovës, RYCO, Qendrat Rinore, Organizatat Rinore, OSBE,UNICEF etj.

## **Kapitulli i 8. Krahasimi i opsiioneve (vlerësimi i pasojave të secilit opzion)**

1. Përfitimet sipas opsonit të parë të ndërlidhura me ruanjien e gjendjes ekzistuese janë kryesisht ato çfarë kanë ekzistuar gjatë më tanit. Ndërsa pasojat negative, do të reflektohen kryesisht në mosdefinimin dhe përcaktimin e çështjeve të shumta të rëndësishme si definimi i statusit te institucioneve publike si dhe detyrat dhë përgjegjësitë e tyre.

2. Opsiioni i dytë do të sillte më shumë përfitime, lidhur me këtë mund të thuhet se vështirë do të ishte të gjendet ndonjë efekt negativ. Ndërsa, sa i përket efekteve pozitive, ato do të jenë të shumta duke filluar nga përkufizimi i fushë veprimitarise, plotësimi i kormizës institucionale, **Gjithashu vlen theksuar, që plotësim/ndryshimi i ligjit do të kishte impakt në mundësitë e krijuara për zhvillimin dhe profesionalizimin e fushës respektive duke ofruar mundësi të zgjidhje më praktike për avancimin e sektorit të ruminës.**

### **Opsiioni i dytë ka efekte pozitive gjithëpërfshirëse**

3. Gjithpërfshirja dhe efikasiteti i trajimit të kërkesave dhe interesave rimore sipas opsonit të dytë nuk do të bëjnë dallime në aspektin rajonal apo territorial, etnikë apo gjimie por përfshijnë tërë qytetaret që jetojnë dhe veprojnë në territorin e Kosovës.

4. Opsiioni i tretë do të kishte përfitime të njëjtë me opsonin e parë, pa ndonjë ndryshim adekuat duke pas parasysh që ndryshimet vetëm në qasjen e zbatimit të ligjit nuk do të prodhonin ndryshme në përfitimet e elaborura në opsonin e parë, por edhe efekti i pasojave negative do të ishte i njëjtë dhe efektit gjithëpërfshirëse do të ishin të njëjtë me opsonin e parë, të ndërlidhura me ruanjien e status quoos ekzistuese pa ndonjë modifikim thelbësor.

5. Opsiioni i dytë i cili parasqeh plotësimin/ndryshimin e Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë do të ishte opzioni më i qëlluar dhe me i rekomanduar për arrijen e synimit dhe objektivave të parapara në pjesën 3.

## **Kapitulli 9. Rekomandimi**

1. Rekomandohet opsonin i dytë, respektivisht plotësim/ndryshimi i Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, me qëllim të rregullimit të shumë çështjeve të rëndësishme përfshirë politikave sektoriale rimore si dhe duke marrë përbazë praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Proceduarat për hartimin e Plotësim/Ndryshimit të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë do të kryesohen nga ana e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Departamenti Rinisë, si akter kryesor, në bashkëpunim me institucionet dhe grupet e interesit që të arrihen objektivat e synuara.

3. Brenda viti 2019 parashihet të përfundoj proceduara e Plotësim/Ndryshimit të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë.

4. Kosto (Zyra për Buxhet dhe Financa/MKRS).

Departamenti i Rinisë						
Buxheti	Viti	Shuma	Viti	Shuma	Viti	Shuma
Pagat dhe mëditjet	2018	146,102.29	2019	156,480.00	2020	156,844.54
Subvencione	2018	1,400,000.00	2019	1,750,000.00	2020	1,750,000.00
Mallra dhe shërbime	2018	6,300.00	2019	6,300.00	2020	10,500.00
Komunali	2018	/	2019	/	2020	/
Investime kapitale	2018	1,150,000.00	2019	600,000.00	2020	600,000.00
<b>Buxheti total</b>	<b>2018</b>	<b>2,702,402.29</b>	<b>2019</b>	<b>2,512,780.00</b>	<b>2020</b>	<b>2,517,344.54</b>

5. Nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit nga Qeveria e Republikës së Kosovës do të formohet ekipi punues për hartimin e Plotësim/Ndryshimit të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë i cili do të përciell informata e përditësuara lidhur tek të gjithë aktoret lidhur me procesin e hartimit të këtij projektligjt.

## **Kapitulli 10. Komunikimi**

1. Akterët kryesorë të fushës janë të informuar për fillimin e procedurave lidhur me hartimin e Koncept Dokumentit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrje e Rinisë. Ata do të janë të njoftuar për çdo veprim të ri në këtë aspekt përmes shkresave zyrtare dhe e-mailave.
2. Me akterët respektiv do të komunikohet bazuar në procedurat e parapara me akte ligjore dhe nën-ligjore, varësisht nga faza e zhvillimit të procedurës.
3. Konsultimet do të realizohen për secilën fazë të procesit, duke filluar nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit.

## **11. Projekt Vendimi i Qeverisë**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim më Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.